




**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN**

PROCESVERBAL

**nga mbledhja e -V-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
16 maj 2019 në mjediset e komunës, e cila filloi në ora 14:15.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Shpëtim Zhegrova, Melihate Basholli-Latifi, Fjolla Ujkani, Ymer Haradinaj, Rrezarta Krasniqi, Shkëlzen Feka dhe Nezir Klinaku (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Besim Muzaqi (nënkryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Lutfi Gërguri, Adnan Lahu, Miran Halil, Sylejman Mehulli, Berat Asllani dhe Bajrush Kosumi), Alban Tahiraj, nga Zyra Ligjore, përfaqësues të OSBE-së, si dhe nga sekretaria, Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ai deklaroi se disa pika kanë ardhur për t'u proceduar edhe në të ndryshme, i cili kërkoi që të futen në rend të ditës.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri rekomandoi që materialet që nuk janë urgjente mos të procedohen në mbledhje të KPF-së dhe kuvendit të komunës gjatë mbledhjes.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e datës 11.04.2019;
2. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave;
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë;
4. Shqyrtimi i peticionit nga banorët e rrugës "Ramadan Fazliu" për largimin e taksive;
5. Shqyrtimi i Draft-planit komunal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë;
6. Shqyrtimi i kërkesës për vendosjen e bustit të heroit Jashar Jashari në oborrin e shkollës Liria në Stroc si dhe emërtimin e shkollës me emrin e tij;
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Gllavatin;
8. Shqyrtimi i kërkesës së komunitetit farmaceutik për ridizajnim të orarit të punës;
9. Njoftimi i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit lidhur me rrugën "Bajram Bozhilani";
10. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e datës 11.04.2019.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri me ndryshime aprovoi procesverbalin e datës 11 prill 2019.

2. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se nëse e keni ndërmend të merreni vesh si në vitin e kaluar për t’i mbivotuar propozimet e juaja, atëherë më mirë mos të propozojmë fare, sepse në kuvend po dalim keq me propozime. Këtu na kanë ardhur tetë (8) propozime, nuk kam asgjë kundër tyre, por më mirë do të ishte që të ketë propozime më shumë dhe se komisioni t’i analizojë dhe ta bëjë një listë prioritare. Po ashtu, Klinaku deklaroi se këto mirënjohje po jepen për “Ditën e Çlirimit” dhe se duhet t’iu jepen atyre që kanë kontribuar për këtë ditë.

Nëse e konsideroni që t’iu jepet mirënjohje atyre që e meritojnë, atëherë po e propozoj Ilmi (Hysni) Saraçin.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së – deklaroi se e kam parë një gjithpërfshirje të aktorëve relevant. Ai pyeti se: A janë përfshirë partitë politike, shoqëria civile? Sa ka zgjatë afati i propozimeve? Nga ana ime, askush nuk është propozuar në këtë listë, tha ai, i cili shtoi se nuk është kundër asnjërit propozim. Ai pyeti se: Kush janë anëtarët e komisionit? Si ka shkuar procedura për përzgjedhjen e propozimeve?

Fatmire Cecelia, drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport – theksoi se me vendim të kryetarit të komunës është formuar komisioni me këtë përbërje: Fatmire Cecelia- kryesuese e komisionit, Afrim Namani, Miran Halili, Sylejman Mehulli dhe Mehmet Selaci. Rregullorja për Dhënien e Dekoratave (gjegjësisht Rregullorja për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Dhënie të Dekoratave) e parasheh që duhet të ndahen 10 mirënjohje. Ne si komision, në bashkëpunim edhe me shoqatat i kemi nxjerrë këto propozime.

Në listën e ndarjes së mirënjohjeve dhe dekoratave nga viti 2002, kemi pasur vështirësi ta gjejmë dikë që nuk ka marrë mirënjohje, tha ajo. Ne si komision i kemi propozuar tetë (8) propozime, të cilat konsideroj se janë të arsyeshëm, kurse në kuvend mund të bëhen edhe propozime tjera. Ajo tha se tri (3) propozime janë dhënë nga: Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së dhe nga Shoqata e të Burgosurve Politikë.

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – propozoi për mirënjohje post-mortum, Hajzer Krasniqin, kurse për çmimin “Pena e artë”, ajo propozoi Remzije Zekollin.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se si anëtarë i komisionit të kuvendit të komunës janë duke punuar në ndryshimin e kësaj rregulloreje. Një person që e ka marrë një mirënjohje apo çmim të nivelit më të lartë, është jonormale t’i ndahet dekoratë me vlerë më të ulët, sepse nuk e lejon rregullorja (rasti i Hajzer Krasniqit).

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – propozoi Ali Januzin për çmimin “Nderi i qytetit”, për kontributin e dhënë si veprimtar i çështjes kombëtare dhe kontributin e çmuar në luftën për çlirimin e Kosovës.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – deklaroi se, ne si PDK e përkrahim propozimin për Ali Januzin që t'i jepet çmimi "Nderi i qytetit".

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – propozoi Xhafer Haradinajn për mirënjohje në fushën e bujqësisë. Ai merret me bujqësi dhe blegtori, i cili edhe ka hapur pikën grumbulluese të qumështit në Stanoc të Epërm, ku shumë fermerë shesin qumështin në këtë pikë grumbulluese.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – tha se në emër të grupit e përkrahim propozimin për Ali Januzin që t'i jepet çmimi "Nderi i qytetit". Shpresojmë që të gjejmë mirëkuptim në mes vete dhe që çdo herë të jetë vetëm një kandidat.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se e përkrah propozimin për Ali Januzin. Por, vitin e kaluar ishte i propozuar Ali Januzi, i cili ishte tërhequr. Pastaj, ka pasë dalë një kërkesë që për shkak të veprimtarisë së përbashkët të Ali Januzit me Idriz Asllanin t'iu ndahet çmimi të dyve. Jemi në komision për ndryshimin e rregullores për dekorata, mirëpo nuk po arrijmë që ta përfundojmë, në mënyrë që të jepet hapësira për t'iu ndarë çmimi "Nderi i qytetit" më shumë se një personi, tha ai.

Konsideroj që në vite jubilarë, siç është 20 vjetori i çlirimit të Vushtrrisë, komuna mund të ndajë më shumë çmime apo mirënjohje. Mirë do të ishte edhe zyra ligjore ta jep një opinion të saj që në këto raste (vite jubilarë) ta tejkalojmë rregulloren në mënyrë që të ndajmë më shumë çmime. Prandaj, propozoj që çmimi "Nderi i qytetit" t'iu ndahet dy veprimtarëve të çështjes kombëtare, Ali Januzit dhe Idriz Asllanit.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - tha se e falënderon Nezirin për propozimin, por ta shohim sa na lejon rregullorja për këtë. Aktiviteti i tyre i përbashkët (Aliut dhe Idrizit) në periudha të caktuara kohore ka qenë i pandashëm. Megjithatë, ndoshta nuk është momenti tani të bëjmë një shmangie nga rregullorja, pasi që ju si komision edhe ne si qeverisje kemi mbetur vonë për ta ndryshuar rregulloren për dekorata. Prandaj, nuk është mirë t'i vendosim në pozitë të keqe anëtarët e KPF-së, por edhe të kuvendit me futjen në konkurrencë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se nuk e futa në konkurrencë Aliun, por propozova që t'iu ndahet dyve ky çmim. Sepse, edhe vitin e kaluar kam biseduar me Ali Januzin për këtë çështje. Prandaj, duke para praktikën e komunave tjera që në vite jubilarë iu ndahen. Konsideroj që pozicioni i Ali Januzit vetëm sa do të përforcohej sikur të jetë bashkë me Idriz Asllanin.

Albanez Tahiraj, zyrtar i lartë në Zyrën Ligjore – deklaroi se rregullorja aktuale për dekorata e parasheh që vetëm një personi t'iu ndahet çmimi "Nderi i qytetit".

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – tha se barazia gjinore nuk po respektohet edhe aq shumë, pasi që në propozimet për mirënjohje kemi një listë meshkujsh. Po ashtu, edhe në përbërjen e komisioneve të ndryshme nuk po është e pranishme barazia gjinore.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – theksoi se pajtohet me Melihatën lidhur me barazinë gjinore. Ajo kërkoi që të caktohet si kriter që edhe barazia gjinore të jetë e pranishme tek propozimet.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së – në informatë thuhet <gjendja momentale e masës drusore në depo është 114.90m³>. Kurse, më poshtë shkruan se: <për vitin 2018 ende nuk kemi bërë shitje edhe pse në depo kemi 117.60m³>. Prandaj, po shihet që kemi një mospërputhje, e të shikohet se mos bëhet fjalë për ndonjë gabim teknik.

Miran Halili, drejtor i Drejtorisë për Inspektime – theksoi se kjo shifër është lëvizëse, por do ta shikojmë edhe një herë se a bëhet fjalë për ndonjë gabim teknik.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i peticionit nga banorët e rrugës “Ramadan Fazliu” për largimin e taksive.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – deklaroi se nuk është e lehtë çasja e atyre banorëve në banesat e tyre, por është e ndjeshme edhe largimi i taksive nga ajo pjese, pasi që nuk kemi një zgjidhje të dytë (pra nuk kemi lokacion të caktuar për vendosjen e taksive). Edhe në të kaluarën, kur është bërë largimi i taksive nga sheshi, nuk ka qenë një vendim i lehtë, por edhe pse janë taksitë aty, nuk do të thotë që ta bllokojnë rrugën. Prandaj, institucionet duhet të funksionojnë (inspektorati, policia) që ta lirojnë atë hapësirë të rrugës, tha ai. Zhegrova deklaroi se Drejtoria për Shërbime Publike me një vendim të veçantë mund ta trajtojë ndryshe këtë pjesë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – në momentin që janë larguar taksitë nga vendi ku kanë qenë dhe janë vendosur aktualisht tani në një rrugë, pyeti se çka është menduar me këtë? Kush e shfrytëzon hapësirën sot ku kanë qenë taksitë më herët? Ka qenë e planifikuar që të bëhet një shesh, por deri më tani nuk është bërë asgjë. Propozoj që taksitë të kthehen prapë në vendin ku kanë qenë, sepse ajo është hapësirë publike, tha Klinaku.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – theksoi se hapësira ku kanë qenë të vendosur në të kaluarën taksitë është menduar që të bëhet sheshi “Hasan Prishtina” dhe ka qenë pjesë e projektit bashkërisht me vendosjen e shtatores së Hasan Prishtinës ku është e vendosur aktualisht. Por, pse është vonuar procedura për shtatoren dhe rrënimin e objektit të komunës, kjo është diçka tjetër. Nëse kthehen taksitë, në hapësirën ku kanë qenë, a do të zgjidhet ky problem? Konsideroj që prapë po bllokohet qyteti dhe po iu jepet edhe më shumë hapësirë për keqmenaxhim të hapësirës, tha Zhegrova.

Drejtoria për Shërbime Publike të vjen me 2 apo 3 propozime për zgjidhjen e këtij problemi, u shpreh ai.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – tha se si komitet, t’i rekomandojmë Drejtorisë për Shërbime Publike që ta analizojë këtë problem dhe të ofrojë zgjidhje afatgjatë.

Mehmet Selaci, drejtor i Drejtorisë për Administratë – deklaroi se në mbledhjen e fundit të bordit (këshillit) të drejtorëve është diskutuar për këtë çështje dhe kanë dalë disa propozime që të ndahet një pjesë e rrugës (korsi) për taksitë në vendin aktual, por edhe të bëhet vendosja e kamerave. Kjo nuk mund të jetë zgjidhje afatgjatë. Por, banorët që jetojnë në objektin banesor në atë rrugë ku gjenden taksitë kanë shumë të drejtë që e kanë ngritur si shqetësim.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – siç e tha edhe drejtori Selaci, edhe në mbledhjen e bordit e kemi diskutuar këtë. Duhet të kemi konsideratë si për banorët ashtu edhe për taksistët. Kudo që të vendosen taksitë, mund të kemi peticion edhe nga ana e tyre. Prandaj, drejtorja kompetente ta analizoj këtë problem dhe të gjej zgjidhjen më të pranueshme.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - tha se në fillim të mandatit, si qeverisje komunale (Drejtorja për Shërbime Publike) kemi marrë një hap dhe i kemi vendosur taksitë në korsinë e majtë të rrugës përballë shtëpisë së kulturës. Pastaj, pas ankesave të bizneseve dhe qytetarëve, kryetari i komunës e ka anuluar vendimin e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe ka marrë vendim për vendosjen e taksive ku janë aktualisht. Prandaj, këtë çështje Drejtorja për Shërbime Publike ta analizojë me kujdes dhe të ofrojë zgjidhjet më të mira.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që Drejtorja për Shërbime Publike ta analizojë këtë çështje dhe të ofrojë zgjidhje afatgjatë deri në mbledhjen e kuvendit të komunës të muajit qershor.

5. Shqyrtimi i Draft-planit komunal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - tha se si kryesues i grupit punues për hartimin e këtij draft-plani iu informojë se kemi pasur katër takime formale, ku edhe është hartuar ky draft. Ky dokument është bazuar në Strategjinë e Republikës së Kosovës lidhur me këto komunitete. Implikimet financiare janë minimale, pasi që jemi bazuar në aktivitetet të cilat i parasheh strategjia, tha ai.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – pyeti se a ka komunitet egjiptian në komunën tonë?

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - deklaroi se nuk ka komunitet egjiptian në komunën tonë.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

6. Shqyrtimi i kërkesës për vendosjen e bustit të heroit Jashar Jashari në oborrin e shkollës Liria në Stroc si dhe emërtimin e shkollës me emrin e tij.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – ndoshta është pak e rëndë të flas unë për këtë situatë, mirëpo kjo kërkesë ka ardhur nga Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së. Tjetra çështje është se le ta lejon komuna vendosjen e bustit, kurse mjetet financiare i mbulon familja. Për mua kjo formë e procedurës nuk është në rregull.

Ai tha se në vitin 1999 janë mbledhur banorët e fshatrave që marrin pjesë në atë shkollë dhe qysh atëherë ka qenë kërkesë që shkollës t'i vendoset emri “Jashar Jashari”. Pas një kohe, ish-objektit të TMK-së në Vushtri i është vendosur emri i “Jashar Jasharit”.

Klinaku deklaroi se nëse ekziston emërtimi i ndonjë objekti me emrin e Jashar Jasharit, më mirë është që busti të vendoset aty. Por, pasi që TMK-ja është shpërbërë dhe se ai objekt nuk besoj që e mbanë emrin e Jashar Jasharit, atëherë ia vlen të mendohet për emërtimin e shkollës në Stroc, sepse e meriton Jashar Jashari që një objekt ta mbajë emrin e tij, madje në Vushtri, e jo vetëm në Stroc, tha ai.

Nëse vendoset që emërtimi i shkollës në Stroc të jetë “Jashar Jashari”, atëherë komuna ta financojë vendosjen e bustit.

Konsideroj se kjo çështje nuk është urgjente, prandaj t’i respektojmë procedurat.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – theksoi se nuk po e konteston kontributin e Jashar Jasharit, por të respektohet legjislacioni. Pra, sa kam informacione, iniciativa për emërtimin e një shkolle duhet të bëhet nga bordi i shkollës në bashkëpunim me mësimdhënësit. Konsideroj që duhet të konsultohet Drejtoria e Arsimit dhe Zyra Ligjore për këtë, në mënyrë që mos të marrim vendime që nuk janë në kompetencë tonë.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – edhe unë konsideroj se nuk është urgjente dhe të respektohen procedurat, në mënyrë që ta marrim një vendim konform rregullave dhe ligjeve në bashkëpunim me drejtorinë kompetente.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – theksoi se duhet të respektohen procedurat për emërtimin e shkollës. Kurse, sa i përket bustit, drejtoria kompetente e planifikon buxhetin.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - tha se është normale që fshati të kërkojë riemërtimin e shkollës dhe vendosjen e bustit të Jashar Jasharit, por ne duhet bashkërisht të ndërmarrim hapa ligjor dhe që nuk shkaktojnë kundërtënie. Fillimisht ka ardhur si kërkesë vetëm vendosja e bustit në oborrin e shkollës “Liria” në Stroc. Pastaj, tash me kërkesë është kërkuar edhe riemërtimi i shkollës. Edhe unë pajtohem që investimi për bustin të jetë i qeverisë lokale, por pas përfundimit të procedurave (riemërtimi i shkollës dhe planifikimi i bustit në buxhet).

Albanez Tahiraj, zyrtar i lartë në Zyrën Ligjore – theksoi se t’i rekomandohet Drejtorisë për Arsim, pastaj kjo drejtori në kuadër të kompetencave me drejtorinë e shkollës i zhvillojnë procedurat.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që Drejtoria për Arsim t’i zhvillojë procedurat për riemërtimin e shkollës “Liria” në Stroc me emrin e dëshmorit Jashar Jashari (Duraku). Pastaj, kur të kryhet riemërtimi, të planifikohet me buxhet vendosja e bustit.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Gllavatin.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – konsideroj që duhet të përdoret termi <legalizim i lokacionit> e jo <aktim i lokacionit>, sepse aty ekzistojnë varrezat. Po ashtu, duhet t’i ndërrohet edhe kultura.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – tha se në terren ekzistojnë varrezat. Në atë hapësirë gjenden 102233m² pronë komunale. Në atë sipërfaqe, një pjesë banorët i kanë bërë varreza dhe ata po kërkojnë që të bëjnë rrethojat e varrezave . Nga sipërfaqja e përgjithshme, ne e kemi menduar që 7200m² të mbetet hapësirë për varreza.

8. Shqyrtimi i kërkesës së komunitetit farmaceutik për ridizajnim të orarit të punës.

Sylejman Mehulli, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – deklaroi se çështjen e ridizajnit të orarit, komuniteti farmaceutik është dashur t’ia adresojë Drejtorisë për Inspektim, pasi që barnatoret ushtrojnë veprimtari biznesore. Por,

jam i gatshëm që bashkërisht me Drejtorinë për Inspektime edhe me komunitetin farmaceutik ta gjejmë një modalitet të përshtatshëm në harmoni me rregulloren komunale.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së – tha se komuniteti farmaceutik është shprehur se me drejtorin e mëhershëm të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale e kanë ndërtuar një orar, e pastaj Drejtoria për Inspektime është përkujdesur që ta zbatojë atë.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - pasi që orarin e kujdestarisë natën e bënë Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, konsideroj që edhe këtë orar për kujdestari të dielën është dashur të përfshihet në kuadër të atij orari, kurse zbatimi i orarit të bëhet nga Drejtoria për Inspektime.

Berat Asllani, drejtor i Drejtorisë për Inspektime – deklaroi se rregullorja parasheh vetëm një kujdestari. Prandaj, pa u ndryshuar rregullorja nuk mund të bëjmë asgjë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se është krijuar një praktikë në këtë qeverisje që po adresohen peticione të shpeshta. Sipas tij, komuniteti farmaceutik është dashur që me drejtoritë kompetente ta gjejnë zgjidhjen

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Inspektime dhe Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ta ftojë komunitetin farmaceutik për të biseduar dhe bashkërisht ta gjejnë një zgjidhje.

9. Njoftimi i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit lidhur me rrugën “Bajram Bozhllani.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – theksoi se vendimi për riemërimin e rrugëve është marrë më 30.11.2015. Prandaj, është mirë që të vjen edhe propozimi i drejtorisë. Këtu siç po shihet, komisioni ia ka aprovuar kërkesën Mursel Feratit.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se duhet ta dimë se emri i rrugës që është ndryshuar, a ka qenë në listë për riemërtim në vitin 2015.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që t'i bashkëngjitet lista e riemërtimit të rrugëve që është votuar dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

10. Të ndryshme.

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – kërkoi vendosjen e një table orientuese në fshatin Begaj për orientimin e qytetarëve për tek varrezat e qytetit.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se ka qenë një projekt për emërimin e rrugëve dhe vendosjen e shenjave. Pse nuk po vendosen shenjat (tabelat) e rrugëve?

Ai tha se është punësuar zyrtari për vendosjen e shenjave, kurse ka shumë rrugë në komunën tonë që nuk janë vendosur shenjat.

Ai kërkoi që personat që janë të ngarkuar për vendosjen e shenjave të rrugëve, të dalin dhe t'i vendosin ato.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – deklaroi se edhe në KPF edhe në kuvend kam kërkuar nga zyra e kryetarit të komunës lidhur me vendet e lira të punës, por nuk kam marrë përgjigje me shkrim. Më vonë e kam kuptuar që përgjegjëse për këtë është zyra e personelit. Prandaj, ai kërkoi nga zyra e personelit se a ka vende të lira në administratën komunale të Vushtrisë? Nëse ka, sa është numri i vendeve të lira dhe pse nuk po shpallen?

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – kërkoi vendimin për shtrimin e rrugës “Indrit Cara”, kontratën e lidhur me kompaninë për rregullimin e kësaj rruge si dhe vendimin për formimin e komisionit.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - lidhur me rrugën “Indrit Cara”, tha se nuk ka pasur kontratë. Aty po kryhen punime private, kurse ne jemi duke e pritur pëlqimin, për shkak se ajo është pronë e Kooperativës Bujqësorë, me kulturë <rrugë>.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – tha se kompania “Shkoza 007” që është e kontraktuar nga komuna është duke punuar aty dhe nuk bëhet fjalë për punime private. Ai tha se procedura e prokurimit nuk është përfillur.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se duhet t'i pranojmë gabimet. Iu kam sugjeruar që duhet të merret pëlqimi nga AKP-ja, sepse nuk mund të shtrohet rruga.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00.

Bujar Klinaku

Bujar Klinaku
Procesmbajtës



Nasuf Aliu

Kryesues i KK-së dhe i KPF-së